**Vendim nr. 343, datë 30.10.2026**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Marsida Xhaferllari, | Kryesuese |
| Ilir Toska, | Anëtar |
| Genti Ibrahimi, | Anëtar |

në datën 30.10.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 14 (D) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **DEFRIM MATMUJA**, përfaqësuar nga avokati Tom Dedaj, me prokurë të posaçme.

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimit nr. 1076-270, datë 22.04.2026 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me tjetër trup gjykues. Ngarkimi i shpenzimeve gjyqësore Ministrisë së Financave.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 17, 32, 42, 43, 49, 50, 51, 71, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i", 145 e vijues të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 e vijues dhe 45 të Konventës Evropian për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 68, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi është arrestuar në flagrancë në datën 07.07.2025, kur shërbimet e Policisë së Mirditës, në aksin rrugor Milot-Morinë, kanë ndaluar automjetin e drejtuar nga ai, në të cilin udhëtonin gjashtë shtetas egjiptianë. Për marrjen e deklarimeve të tyre është thirrur një përkthyes i gjuhës arabe nga kampi i Gjadrit, i licencuar dhe i njohur nga shteti italian dhe Bashkimi Evropian, i cili zotëronte edhe gjuhën shqipe. Sipas deklarimeve të shtetasve të huaj, ata kishin ardhur nga Greqia dhe synonin të shkonin në Bosnjë-Hercegovinë.

2. Ndonëse prokurori ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me vendimin nr. 1937-349, datë 10.07.2025, ka caktuar masën e sigurimit të arrestit në shtëpi. Ky vendim është miratuar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm me vendimin nr. 2132 (30-2025-6843), datë 12.08.2025.

3. Në datën 03.12.2025 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka marrë në cilësinë e të pandehurit kërkuesin, duke i komunikuar akuzën për kryerjen e veprës penale "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve", të parashikuar nga neni 298, paragrafi i tretë, i Kodit Penal.

4. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë (gjyqtari i seancës paraprake), me vendimin nr. 1076-270, datë 22.04.2026, ka vendosur pranimin e kërkesës për dërgimin për gjykim të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit, sipas akuzës së ngritur nga prokurori.

5. Në datën 05.08.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

**II**

**Pretendimet e kërkuesit**

6. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

6.1. *E drejta e mbrojtjes,* pasi atij i është mohuar mundësia për të marrë gjatë fazës së hetimit paraprak aktet e fashikullit të hetimit, për të paraqitur prova, për të pyetur

dëshmitarë dhe për t'u ballafaquar me ta dhe kjo ka sjellë, për pasojë, edhe mohimin e mundësisë për të kërkuar gjykimin e shkurtuar. Kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq nuk ka të shënuar datë dhe atij nuk i është njoftuar. Ai është thirrur nga prokuroria dhe ka nënshkruar në prani të oficerit të Policisë Gjyqësore disa shkresa e dokumente, të cilat ishin hartuar e mbledhur gjatë hetimit. Pavarësisht se ka paraqitur dy kërkesa për vënien në dispozicion të këtyre akteve, ai nuk ka mundur t'i administrojë ato. Gjashtë kërkesat e tij për pavlefshmëri e papërdorshmëri të procesverbaleve për marrjen e deklarimeve nga shtetasit e huaj, për shkak se nuk janë respektuar dispozitat ligjore procedurale, për sa i takon përkthimit të tyre, kanë mbetur pa përgjigje nga gjykata.

6.2. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi gjykata me vendimin për kalimin e çështjes për gjyq ka miratuar *apriori* në bllok çdo akt të paraqitur nga prokurori.

6.3. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq është absolutisht i paarsyetuar.

## III
## Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës*

7. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund t'i drejtohet Gjykatës për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes, Kolegji mund të verifikojë një ose më

shumë prej këtyre kritereve, pa qenë i detyruar të ndjekë një radhë të paracaktuar të analizës. Mospërmbushja e njërit prej tyre, që sjell si pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera.

9. Në rastin konkret, Kolegji çmon të ndalet në verifikimin e plotësimit të kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive,* për të cilin Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion subsidiar, ndaj, si rregull, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor, pasi individi ka shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Qëllimi i kësaj dispozite kushtetuese është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se objekt i kontrollit kushtetues, përjashtimisht, mund të jenë edhe vendimet, të cilat nuk vendosin për themelin e çështjes, kur plotësojnë njëkohësisht këto kritere: (i) vendimi të ketë vendosur mbi të drejtën themelore, duke sjellë drejtpërdrejt shkeljen e saj; (ii) vendimi të jetë shqyrtuar nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën e pretenduar si të cenuar; (iii) vendimi të ketë një shkallë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që vendimi përfundimtar nuk mund ta ndryshojë atë ose të riparojë në mënyrë të përshtatshme pasojat e tij (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 22, datë 04.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Kontrolli kushtetues i këtyre vendimeve përbën një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, i justifikuar nga natyra dhe pasojat e drejtpërdrejta që ato sjellin për të drejtat themelore të individit. Për rrjedhojë, ky përjashtim zbatohet vetëm në ato raste kur vendimi ka autonomi në raport me procesin gjyqësor të themelit, ku përcaktohet (pa)fajësia e personit, dhe kur cenimi i pretenduar i të drejtave themelore buron drejtpërdrejt prej tij, pa qenë i mundur riparimi i përshtatshëm i pasojave përmes vendimit përfundimtar.

11. Mbi bazën e këtij standardi, Kolegji vëren se objekt i ankimit kushtetues individual në shqyrtim është vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me të cilin është pranuar kërkesa e Prokurorisë së Lezhës për dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit. Pra, bëhet fjalë për një vendim gjyqësor që i ka hapur rrugë shqyrtimit në themel të akuzës penale për dhënien e ndihmës për

kalimin e paligjshëm të kufirit. Ky vendim nuk përcakton në mënyrë përfundimtare (pa)fajësinë e kërkuesit dhe, për nga natyra e tij, nuk sjell pasoja të drejtpërdrejta, të menjëhershme dhe të pariparueshme në të drejtat e tij themelore, që do të justifikonin përjashtimisht ushtrimin e kontrollit kushtetues përpara përfundimit të procesit gjyqësor. Po kështu, pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor lidhen me aspekte që mund të shqyrtohen gjatë gjykimit në themel të çështjes nga gjykatat e zakonshme, të cilat kanë detyrimin të garantojnë respektimin e të drejtave procedurale në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ-në. Në këtë kuptim, kërkuesi ka në dispozicion mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij gjatë procesit gjyqësor, ku mund të parashtrojë, personalisht ose nëpërmjet mbrojtësit, pretendimet në lidhje me akuzën, të paraqesë provat që i konsideron të nevojshme dhe të kundërshtojë provat dhe pretendimet e akuzës. Gjithashtu, ai ka të drejtë të kundërshtojë vendimin përfundimtar në gjykatat më të larta dhe, pas shterimit të mjeteve juridike efektive, t'i drejtohet edhe Gjykatës për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese.

12. Për sa më lart, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara vënies në lëvizje të gjykimit kushtetues, për rrjedhojë ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja "d", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.